



REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo	
Ministria e Financave / Ministarstvo za Financije Ministry of Finance	
Administrata Tatimore e Kosovës / Poreska Administracija Kosova / Tax Administration of Kosovo	
ARKIVA / ARHIVA / ARCHIVE	
Njësinë Org. Org. Jedin.	Nr. Prot. Br. Prot.
Org. Jedin.	Prot. No:
Nr. i faqeve Broj stranica No. pages:	Data Datum Date:
Dalëse	PRISHTINË/A

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

ndërmjet

ADMINISTRATËS TATIMORE TË KOSOVËS

dhe

FONDIT TË KURSIMEVE PENSIONALE TË KOSOVËS

Ky Memorandum Bashkëpunimi lidhet mes palëve nënshkruese me qëllim të ruajtjes së konfidencialitetit të të dhënave në të cilat iu jepet qasje zyrtarëve të ATK-së nëpërmjet sistemit të FKPK-së dhe është në pajtueshmëri me dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 03/L-222 mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat, nenin 84 (Konfidencialiteti i Informatave Tatimore) dhe dispozitat ligjore të Ligjit Nr.03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Neni 1

Palët Nënshkruese

- Administrata Tatimore e Kosovës** (më tej ATK), si Autoritet përgjegjëse dhe për mbledhjen e kontributeve pensionale bazuar në autorizimet e dhëna në Nenin 2 të Ligjit Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, e përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm Z. Sakip Imeri dhe
- Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës** (më tej FKPK), si Institucion i përgjegjës për administrimin dhe menaxhimin e llogarive individuale të pensioneve, bazuar në të drejtat dhe përgjegjësitë që burojnë nga Neni 1 par. 23 të Ligjit Nr. 04/L-101 dhe më tej siç parashihet me Kreun III të të njëjtit Ligj, i përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv. Z. Adrijan Zalli.

Neni 2

Qëllimi i Memorandumit të Bashkëpunimit

- Qëllimi i këtij Memorandumi të Bashkëpunimit është ruajtja e konfidencialitetit të të dhënave në të cilat zyrtarëve të ATK-së hasin gjatë ushtrimit të detyrave zyrtare nëpërmjet sistemit të FKPK-së.
- Informatat konfidenciale janë të gjitha informatat ose materialet të cilat kanë përmbajtje të të dhënave personale të kontribuuesve të Fondit, si: emra, mbiemra, numra personal, bilancin e



pasqyrës së kontributeve, si dhe çdo informatë tjetër që sipas Ligjit për mbrojtje të të dhënave konsiderohet si personale dhe e mbrojtur, e të cilat përpunohen nga zyrtarët e ATK-së.

Neni 3

Zbatimi dhe fushëveprimi

1. Palët, në zbatim të kësaj marrëveshje pajtohen që zyrtarët e ATK-së, të cilët kanë qasje në sistemin e FKPK-së, do të mund të ushtrojnë veprimet si në vijim:
 - 1.1 Shtypjen e pasqyrës individuale;
 - 1.2 Shikimin e llogarisë individuale;
 - 1.3 Regjistrimin e aplikacioneve për pension;
 - 1.4 Ndërrimin e të dhënave të kontaktit (e-mail, telefon, adresë) të kontribuuesve;
 - 1.5 Shtypjen e pasqyrës së punëdhënësit
 - 1.6 Çdo kërkesë tjetër e aprovuar paraprakisht nga FKPK-ja.
2. Palët pajtohen që informatat konfidenciale do t'iu zbulohen vetëm zyrtarëve të ATK-së, të cilëve iu aprovohet qasja në sistemin informativ të FKPK-së si dhe në pajtim me depozitat ligjore të Ligjit nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat.
3. Zyrtarët e autorizuar të ATK-së do t'i ndërmarrin veprimet nga pika 1 vetëm me kërkesë të kontribuuesve prezent ose personave të autorizuar prej tyre.
4. Ky Memorandum Bashkëpunimi do të interpretohen në pajtim me Legjislacionin ligjore të aplikueshme.

Neni 4

Hyrja në Fuqi

1. Ky Memorandum Bashkëpunimi do të fillojë së zbatuari nga data e nënshkrimit dhe mbetet në fuqi deri kur ndonjëra palë njofton me shkrim palën tjetër për tërheqjen nga i njëjti.
2. Ky memorandum është i nënshkruar nga personat e autorizuar dhe është i hartuar në 4 (katër) kopje të njëjta, nga 2 (dy) kopje për secilën nga palët nënshkruese.



Administrata Tatimore e Kosovës
Poreska Administracija Kosova
Tax Administration of Kosovo



Trusti

FONDI I KURSIMEVE PENSIONALE TË KOSOVËS

Për: Administratën Tatimore të Kosovës

Emri:

Saliq

Nënshkrimi:

Z. Qendrore

Datë:

23/03/2018



Për: Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës

Emri:

ADRIAN ZALLI

Nënshkrimi:

[Signature]

Datë:

22/3/2018

